



2

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE  
U PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN

Nr. 12796/2011

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDËRVAJTJE NE PRIZREN-me Gjyqtarin Gani Kastrati me procesmbajtesen Mire Beqiraj , ne proceduren kundervajtese kunder te pandehures: Nazmije Selatin Paqarizi nga Prizreni rruga „ Azem Hajdari”,nr. 29, përshkak të kundervajtjes nga neni 16 paragrafi 1.1, e lidhur me nenin 6 dhe nenit 3, të Ligjit nr. 03/L-151, për deklarimin , preardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve t lartë publik, e ne baze te nenit 195 , të LMK-se me dt. 20.12.2011 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**E PANDEHURA:** Nazmije Selatin Paqarizi nga Prizreni rruga „ Azem Hajdari”,nr. 29, Turke, Kosovare, me profesion menagjere e prokurorimin në Spitalin e Prizrenit , ka të kryer Fakultetin, e martuar nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike.

**Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S**

Sepse e pandehura nuk e ka bërë në afatin e rregulltë ligjor deri me dt. 31.03.2011, deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë, si pas kërkesës së AKK- gjegjësisht nuk e ka përmbushur obligimin e saj ligjor për deklarimin e pasurisë brenda afatit .

-me te cilin veprim ka kryer kundervajtjen nga neni 16 paragrafi 1.1, e lidhur me nenin 6 dhe nenit 3, të Ligjit nr. 03/L-151, për deklarimin , preardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve t lartë public, mirëpo gjykata duke aplikuar nenin 9, të LMK-së, ja zbuti denimin nën masen minimale për atë lloj të kundervajtjes , mu për këtë:

**D E N O H E T**

**Me gjobë në shumen prej 50 euro ( Pesëdhjet ) euro.**

I pandehuri është I obliguar që gjoben e shqiptuar të paguaj ne afat prej 15 ditesh, nga dita e plotfuqishëmiris se aktvendimit. Poqese I pandehuri nuk e paguan gjoben brenda afatit të caktuar e njejta do të zevendsohet me denim me burgë , duke llogaritur 15, për një ditë burgu , dhe në emër të shpenzimeve të procedures në afat të njejtë obligohet të paguaj 5 euro .

**A r s y e t i m**

Me kërkesen Agjensis kunder Korrupsionit për deklarimin e pausrisë në Prishtinë , me nr. 01-3245/2011, të dt. 12.07.2011, është ngritur procedura kundervajtese kunder të pandehures: Nazmije Paqarizi nga Prizreni, për shkak te kundervajtjes si në dispozitiv të ketij aktvendimi.

Gjykata me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ka ndegjuar dhe marrur në pyetje të pandehuren në seancen verbale të mbajtur me dt. 22.08.2011, e cila në mbrojtjen e vet kundervajtjen për të cilën është e ngarkuar e kontestoi me një përjashtim të veqant duke arsyetuar faktin se paraprakishtë nuk ka qenë e njoftuar me ndonjë shkresë zyrtare nga Agjensionin kunder korrupsionit lidhur me deklarimin e rregullt vjetër të pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, dhe këtë e thekson nënë përgjegjësin e saj të plotë morale e materjale se nuk ka pranuar ndonjëher me pare ndonjë njoftim apo formular nga AKK. Në të vërtet e pandehura në deklaratën e saj thekson se vitin e kaluar ka përmbushur obligimin lgijor ka deklaruar gjendjen e pasurisë së saj , kurse në këtë vitë e njejta thekson se nuk ka pranuar formularë ngase në të kundertë me siguri do ta përmbush obligimin ligjor thekson e pandehura në deshmin e saj duke theksuar se posedon vetëm një shtepi banimi nga viti 1963, mirëpo në nderkohë e paraqitura para nxjerrjes së aktvendimit I ka prezentuar gjykates në shikim formularin për deklarimin e pasurisë të cilës I është derguar nga AKK, dhe se të njejtën formular me nr. 2011, të plotësuar përkitazi me deklarimin e pasurisë ju ka derguar edhe Agjensis së antikorrupsionit në Prishtinë ku dt. dorëzimit të formularit është 15.09.2011, qka do të thotë 2 muaj pas inicimit të kërkesës për fillimn e procedures kundervajtëse ndaj të pandehures por që në faktë formulari I prezentuar nuk është I protokoluar – I vërtetuar nga AKK , për deklarimin e pasurisë në Prishtinë , dhe një kopje e originalit mbetet në shkresat e lëndes si prove materajle ku shifet se e njejta e ka përmbushur obligimin e rregulltë ligjor pas përfundimit të afatit të dhënë të rregullt ligjor të dt. 31.03.2011.

Përveq kesaj Gjykata ka ndëguar edhe parashtresin e kërkesës , gjegjësishtë përfaqësuesin e autorizuar juridik Afrim Atashi , zyrtarë I lartë për mbikqyrje në AKK –Prishtinë I cili pasi u njoftua me lenden e shqyrtimit në dëshmin e tij përveq se ka ngelur pranë veprimeve –shenimeve të cekura në kërkes lidhur me kundervajtjen e ngarkuar për të pandehuren ka theksuar edhe atë se vërtet e pandehura Nazmije Paqarizi nuk e ka bërë deklarinimin e pasuris në afatin ligjor në AKK-Prishtinë , edhe pse e njejta ka qenë e njoftuar paraprakishtë nga pikat kontaktuese që është në Ministrin e shëndetësis në Prishtinë , ku e njejta dëshmi është e bashkangjitur edhe në kërkes –lista e zyrtarve të lartë të pranuar nga zyrtari kontaktues në MSH, dhe është bashkangjitur kërkesës edhe njoftimi për zyrtarë të lartë publik, nga Ministria e shëndetësisë për Spitalin e Prizrenit me emrat e zyrtarëve të lartë publik të cilët nuk e kanë bërë deklarinimin e pasurisë brenda afatit ligjor. Kurse në pytjen e gjyqtarit përfaqësuesi I autorizuar I kërkesës thekson se formularet e plotësuar për deklarinimin e pasurisë të cilat I ka prezentuar –derguar e pandehura në AKK, janë përmbushur pas afatit të rregullt ligjor qka done të thotë mbi 2 muaj , me vones, pasi që e njejta si zyrtare e lartë që është në listen e Spitalit të Prizrenit , ka pasur obligim ligjor për deklaruar pasurin ka apo ska ,poashtu I prezentoj gjykates në shikim një imell zyrtarë nga pikat kontaktuese në Prishtinë se ju ka derguar listen me emrat të zyrtarëve të lartë public nga MSH, në AKK-Prishtinë , ku shifet se formularet janë shpërndarë me kohë dhe në mënyrë të rregulltë, ndaj në fundë thekson se e paraqitura mbanë përgjegjësi kundervajtëse për mos dorëzime formularit për deklarinimin e pasuris janë jashtë afatit të rregullt ligjor , duke theksuar atë se prezentimi I formularit mund të mirret si rrethan lehtësuese në caktimin dhe shqiptimin e denimit.

Gjykata pas administrimit të provave në shkresat e lëndes, deklaratës së të pandehures ,deklaratës së parashtresit të kërkesë –përfaqësuesit të autorizuar juridik, kërkesës së organit dhe provave tjera në shkresat e lëndes ka konstatuar dhe vërtetuar ekzistimin e kundervajtjes bërë nga ana e të pandehures, ndaj edhe për këtë e ka shpallur përgjegjës dhe I është shqiptuar denim me gjobë si në dispozitiv të ketij aktvendimi , dhe me rastin e caktimit të denimit janë vlersuar rrethanat nën të cilat është kryer kundervajtja , pesha e veprës kundervajtëse dhe shkalla e përgjegjësis se të pandehures, sjellja e saj korrekte në gjykatë, është kundervajtja e parë dhe e pa qellimtë prezentimi I formularëve se e njejta ka përmbushur obligimin ligjor për deklarinimin e pasuris ku Gjykata e muar si rrethan lehtësuese , prandaj duke pasur parasysh rrethanat nga neni 7 –të LMK-së, dhe duke aplikuar nenin 9, të LMK-së, të pandehures ja zbuti denimin nën masen minimale të përcaktuar për atë lloj të Kundervajtje duke I shqiptuar denimi me gjobë, me bindje se edhe me këtë do të arrihet qellimi I denimit, në preventive tek e pandehura dhe të tjerët .

Shpenzimet e procedurës janë të caktuara në bazë të neni 109 al.2, të Ligjit mbi kundervajtje.


Në bazë të atyre u cek u vendos shikim në dispozitiv të ketij aktvendimit.

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NE PRIZREN**

Nr. 12796/2011

Procesmbajtjesja

Mire Beqiraj



dt.20.12/2011

Gjyqtari

Gani Kastrati

**UDHEZIMI JURIDIK:** Kunder ketij aktvendimi në afat prej 8 ditësh nga dorezimi mund të ushtrohet ankesa Gjykates së Lartë për Kundervajtje në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES		REPUBLIC OF KOSOVO	
Agjencia e Komunikimit dhe Informimit			
AGENCIJA KOMUNIKIMIT DHE INFORMIMIT			
AGENCY FOR COMMUNICATION AND INFORMATION			
Dep.		Nr. mbi	
Dep.	D-P	R. nr.	03-5116/11
Nr. i dës.		Pr. nr.	
Nr. i dës.	01	Dat.	29.12.2011